



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.19/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Arafat Basha, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Kamenicë, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Kamenicë, paraqitur kundër vendimit Nr. 1623/23-2017 datë 12.09.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të decertifikimit nga gara për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2017, si kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Kamenicë, në seancën e panelit të mbajtur me 15.09.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i Arafat Basha, për anulimin e vendimit Nr. 1623/23-2017, datë 12.09.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, me të cilin, parashtruesi i apelit është decertifikuar si kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Kamenicë, nga partia politike Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

Parashtruesi i apelit Arafat Basha, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Kamenicë, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Kamenicë, me datën 13.09.2017, ka paraqitur apel në PZAP, kundër vendimit Nr. 1623/23-2017, të datës 12.09.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me të cilin pretendon se KQZ-ja e ka decertifikuar nga lista e kandidatëve për Kuvendin Komunal në mënyrë të padrejtë. Andaj parashtruesi i apelit kërkon nga PZAP-i, që ta anuloj vendimin Nr. 1623/23-2017 të datës 12.09.2017, të KQZ-së, lidhur me decertifikimin e tij nga gara si kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal të LDK-së në Kamenicë, pasi që i njëjti thekson se vepra me të cilën është i dënuar është me kusht dhe e natyrës së lehtë e cila nuk korrespondon me pozitën që pretendon ta ushtrojë.

KQZ-ja, në përgjigjen në apel ka theksuar, se ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), që të bëjë verifikimin e kandidatëve që marrin pjesë në garë zgjedhore për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 22 tetor 2017, nëse të njëjtit janë dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm nga Gjykatat e Republikës së Kosovës. Në këtë rast Arafat Basha, kandidat për asamble komunale në Kuvendin Komunal në Kamenicë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Kamenicë, është i dënuar për vepër penale, në bazë të Aktgjykimit

P.nr 165/2015 të datës 11.05.2017 të Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Kamenicë, i cili aktgjykim është bërë i plotfuqishëm me datën 06.07.2017. Andaj KQZ-ja, pretendon në përgjigjen në apel se ka vepruar konform nenit 29 par. 4 Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), me rastin e marrjes së vendimit Nr. 1623/23-2017, që kandidati Arafat Basha të decertifikohet si kandidat i listës së subjektit politik LDK, me propozim për panelin e PZAP-it, që apeli të refuzohet si i pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e apelimit, në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerësoi lejueshmërinë e apelit dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 122 të LZP-së dhe nenin 10 të Rregullës Nr. 02/2015- Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të apelit se me rastin e marrjes së vendimit Nr. 1623/23-2017 datë 12.09.2017 nga KQZ-ja, lidhur me decertifikimin e tij nga gara e listës së kandidatëve për anëtarë të kuvendit komunal në Kamenicë, ju është bërë e pa drejtë ngase vepra me të cilën është i dënuar është me kusht dhe e natyrës së lehtë. Paneli vlerëson se pretendimet e parashtruesit të ankesës janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj dhe si të tilla u refuzuan, sepse neni 29 par. 1, pika q), i LZP-së, për cakton se: *“cilido person emri i të cilit paraqitet në Listën e Votuesve, është i aftë për certifikim, përveç nëse personi është shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit”*, siç edhe është në rastin konkret ngase kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Kamenicë Arafat Basha, me aktgjykimin P.nr 165/2015 të datës 11.05.2017 të Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Kamenicë, i cili është bërë i bërë i plotfuqishëm me datën 06.07.2017, është shpallur fajtor për vepër penale në tri vitet e fundit para certifikimit.

Mbi këtë bazë Paneli, konstaton se KQZ-ja, me rastin e marrjes së vendimit Nr. 1623/23-2017 datë 12.09.2017, drejt ka zbatuar dispozitën ligjore të nenit 29 par. 4 të LZP-së, pasi që kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Kamenicë Arafat Basha, nga radhët e subjektit politik LDK, pasi që është certifikuar nga KQZ-ja, si kandidat, me të dhënat që kanë rezultuar nga KGJK-ja, e ka humbur aftësinë për të qenë kandidat sipas dispozitës ligjore të nenit 29 par. 1 pika q), të LZP-së, pasi i njëjti është shpallur fajtor për vepër penale me aktgjykim përfundimtar në tri (3) vitet e fundit, sipas aktgjykimit, P.nr 165/2015 të datës 11.05.2017 të Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Kamenicë, është bërë i bërë i plotfuqishëm me datën 06.07.2017. Mbi këtë bazë vendimi i KQZ-së, për decertifikimin e apellesit dhe largimin e tij nga lista e kandidatëve të subjektit politik është i ligjshëm dhe çdo pretendim në apel është i paqëndrueshëm.

Paneli me rastin e vendosjes mori parasysh edhe dispozitën e nenit 45 par. 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në të cilin përcaktohet se : *“Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën 18 vjeç, qoftë edhe në ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të*

zgjedhet me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor”. Kjo e drejtë e garantuar me kushtetutë parashtruesit të apelit nuk ju është kufizuar me vendimin e ankimit të KQZ-së, pasi që pikërisht me nenin 55 par. 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: “Te drejtat dhe liritë themelore të garantuar me këtë Kushtetutë mund të kufizohen vetëm me ligj”. Ndërsa, në rastin konkret kjo e drejtë parashtruesit të apelit për tu zgjedhur ju është kufizuar me nenin 29 par. 4, të LZP-së, pasi që parashtruesi i apelit e ka humbur aftësinë për të qenë kandidat sipas nenin 29 par. 1, pika q), të LZP-së.

Sipas vlerësimit të panelit edhe përmbajtja e dispozitës së nenit 45 të Kushtetutës, “gëzon të drejtën të zgjedh dhe të zgjedhet me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor” është komentuar, në komentarin e Gjykatës Kushtetuese¹, në këtë rast kemi të bëjmë me formën e dytë të mbrojtjes gjyqësore të kësaj të drejtë, në kuptimin që Kushtetuta në këtë paragraf në nenin 45 paraqet prezumime për vendosjen e disa shkallëve dhe të formave të mbrojtjes së kësaj të drejte, e cila më vonë rregullohet me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë. Në vështrim të këtij Ligji, shkalla e parë dhe forma e mbrojtjes së kësaj të drejte është mbrojtja administrative brenda Komisionit Qendror Zgjedhor (neni 64 lidhur me nenin 98); e dyta është në PZAP si institucion i përhershëm dhe i pavaruar në përbërje prej gjyqtarëve (105;118-119), ndërsa e treta është mbrojtja e plotë gjyqësore në Gjykatën Supreme të Kosovës (neni 118.4)”. Nga kjo rezulton se mbrojtja e të drejtës gjyqësore e garantuar me Kushtetutë konsumohet me vendimin e PZAP-së dhe mundësinë që i njëjti të ankimohej në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par. 3, 118 par. 1, 122 par. 1, pika b) të LZP-së, si dhe nenit 11 par. 6 të Rregullës Nr. 02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr. 19/2017 më datën 15.09.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.

¹ Enver Hasani & Ivan Čukalović, Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, fq. 159-167, Dhjetor 2013.